



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KONTROLLI I LARTË I SHTETIT
K R Y E T A R I

Nr. 412/1 Prot.

Tiranë, më 30.04.2015

V E N D I M

Nr. 49, datë 30.04.2015

MBI MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË INSTITUCIONIT TË KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT

Në zbatim të nenit 25 dhe 34 të Ligjit nr. 154/2014 “Për funksionimin dhe organizimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”, si dhe nenit 4 dhe 7 të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, nisur nga rëndësia që ka përgatitja dhe zbatimi i Programit Institucional të Transparencës nga institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit;

VENDOSA:

1. Miratimin e Programit të Transparencës për Institucionin e Kontrollit të Lartë të Shtetit, i cili përcakton kornizën ligjore të veprimtarisë së institucionit në kuadër të ligjit nr.119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”.
2. Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit, ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale, nëpërmjet vënies në dispozicion të publikut, pa kërkesë, të informacioneve, me qëllim pakësimin e nevojave për kërkesa individuale për informacion.
3. Programi i Transparencës i Kontrollit të Lartë të Shtetit, përmban parasysh interesin me të mire të publikut në garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik, vënien në dispozicion, pa kërkesë, të informacioneve, si dhe modelin e miratuar nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të ligjit nr.119/2014.
4. Institucioni i Kontrollit të Lartë të Shtetit do të përditësoje, sa herë që është e nevojshme Programin e Transparencës, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të ligjit nr.119/2014, nëpërmjet pasqyrit të detajuar të tij në faqen zyrtare të institucionit.
5. Kategoritë e informacionit që bëhen publike pa kërkesë, përgatiten në formate lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku, duke respektuar kriteret dhe standardet e përcaktuara në nenin 7 të ligjit nr.119/2014.

6. Koordinator “Për të Drejtën e Informimit” , mban dhe bën publik një regjistër të posaçëm, ku pasqyrohen të gjitha kërkesat për informim dhe informacionet e dhëna në përgjigje të tyre.
7. Ky regjistër përditësohet çdo 3 muaj dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
8. Për ndjekjen e zbatimin e këtij urdhri, ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm dhe Koordinatori “Për të Drejtën e Informimit”.
9. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETAR

BUJAR LESKAJ

